



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE**

**Kodi 236**

**SHPALLJE PËR  
LËVIZJE PARALELE DHE PËR PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL  
NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Specialist në Inxhinieri Informatike/Teknologji  
Informacioni/Gjeologji/Informatikë/Gjeoinformatikë/Gjeografi  
niveli “Master Profesional”

Në zbatim të nenit 22 dhe të nenit 25, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar, si dhe të Kreut II, III, IV dhe VII të Vendimit nr. 243, datë 18/03/2015, të Këshillit të Ministrave, Instituti i Statistikave, shpall procedurat e lëvizjes paralele dhe të pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive, për pozicioint:

- 1 (një) Specialist në Sektorin e Gjeoinformacionit dhe Regjistrin Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave në Drejtorinë e Statistikave Rajonale dhe Gjeoinformacionit, klasa e pagës IV-1.

Pozicioni më sipër, u ofrohet fillimisht nëpunësve civilë të së njëjtës kategori për procedurën e lëvizjes paralele! Nëse në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ky pozicion është ende vakant, ai është i vlefshëm për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive.

Për të dy procedurat (lëvizje paralele dhe pranim në shërbimin civil në kategorinë ekzekutive) aplikohet në të njëjtën kohë!

Afati për dorëzimin e dokumentave për LËVIZJE PARALELE: **14 Tetor 2024**  
Afati për dorëzimin e dokumentave për PRANIM NË SHËRBIMIN CIVIL: **17 Tetor 2024**

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,  
Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) / [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE

### **Përshkrimi përgjithësues i punës për pozicionet si më sipër është:**

Specialisti përgjigjet tek Përgjegjësi i Sektorit për menaxhimin e çështjeve, që lidhen me sistemet e informacionit gjeohapsinor dhe të dhënat statistikore të referuara gjeografikisht në Institutin e Statistikave, ku përfshihen krijimi, ruajtja, përditësimi, zhvillimi, analizimi dhe publikimi. Specialisti përgjigjet te përgjegjësi i sektorit edhe për krijimin, përditësimin dhe mirëmbajtjen e Regjistrit Statistikor të Ndërtesave dhe Banesave.

### **1. LËVIZJA PARALELE**

Kanë të drejtë të aplikojnë për këtë procedurë vetëm nëpunësit civilë të së njëjtës kategori, në të gjitha insitucionet pjesë e shërbimit civil.

#### **1.1 KUSHTET PËR LËVIZJEN PARALELE DHE KRITERET E VEÇANTA**

Kandidatët duhet të plotësojnë kushtet për lëvizjen paralele si vijon:

- a- Të jetë nëpunës civil i konfirmuar, në kategorinë ekzekutive;
- b- Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;
- c- Të ketë të paktën vlerësimin e fundit “mirë” apo “shumë mirë”;

Kandidatët duhet të plotësojnë kërkesat e posaçme si vijon:

- a- Të ketë arsim të lartë në Inxhinieri Informatike/Teknologji Informacioni/Gjeologji/Informatikë/Gjeoinformatikë/Gjeografi, niveli “Master Profesional”. Edhe diploma Bachelor të jetë në të njëjtat fusha.

#### **1.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Jetëshkrim i aplikantit dhe kërkesa për aplikim;
- b- Fotokopje të diplomës
- c- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- d- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- e- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- f- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore;
- g- Vlerësimin e fundit nga eprori direkt;
- h- Vërtetim nga Institucioni që nuk ka masë disiplinore në fuqi.

---

### **INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) / [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



## REPUBLIKA E SHQIPËRISË INSTITUTI I STATISTIKAVE

i- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton dokumentet e përmendura në jetëshkrimin tuaj; Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brenda datës **14 Tetor 2024**.

### 1.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK

Në datën 16 Tetor 2024, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kërkesat e posaçme për procedurën e lëvizjes paralele, si dhe datën, vendin dhe orën e saktë kur do të zhvillohet intervista. Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e lëvizjes paralele dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht nga Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institutin e Statistikave, (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

### 1.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET INTERVISTA

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

1. Njohuritë mbi Ligjin Nr. 17/2018 Për Statistikat Zyrtare - [http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018\\_per-statistikat-zyrtare.pdf](http://www.instat.gov.al/media/3973/ligj-nr-17-dt-542018_per-statistikat-zyrtare.pdf)
2. Njohuritë mbi Ligjin e Nëpunësit Civil Nr. 152/2013 - <https://www.dap.gov.al/images/Legjislacionishc/Ligji%20152%20perditesuar.pdf>
3. Njohuri në produktet ESRI: ArcGis Desktop; Arcgis Pro, Arcgis online; aplikacionet GIS (ArcGis WEB, ArcGis Dashboard; story maps, Data Hub).
4. Njohuri në programim në GIS dhe skriptet në “python”.
5. Njohuri mbi klasifikimet NUTS të Komunitetit Evropian, Urban Audit City, Degurba, Grid Data [https://ec.europa.eu/eurostat/statisticsexplained/index.php?title=Territorial\\_typologies\\_m anual](https://ec.europa.eu/eurostat/statisticsexplained/index.php?title=Territorial_typologies_m anual)
6. Njohuri mbi “Principles and Recommendations for Population and Housing Censuses Rev3” [https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series\\_M67Rev3en.pdf](https://unstats.un.org/unsd/publication/seriesM/Series_M67Rev3en.pdf)

#### INSTITUTI I STATISTIKAVE

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) / [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

7. Njohuri mbi “Handbook on Geospatial Infrastructure in support of Census Activities”  
[https://unstats.un.org/unsd/demographic/standmeth/handbooks/series\\_f103en.pdf](https://unstats.un.org/unsd/demographic/standmeth/handbooks/series_f103en.pdf)
8. Njohuri mbi Direktivën INSPIRE në lidhje me statistikat të Komunitetit Evropian, temat: Shpërndarja e Popullsisë/Demografia dhe “Njësitë Statistikore”  
<https://inspire.ec.europa.eu/id/document/tg/pd> dhe  
<https://inspire.ec.europa.eu/id/document/tg/su>
9. Njohuri mbi Infrastruktura Kombëtare të të Dhënave Hapësinore - NSDI”  
[http://www.qbz.gov.al/botime/fletore\\_zyrtare/2012/PDF-2012/31-2012.pdf](http://www.qbz.gov.al/botime/fletore_zyrtare/2012/PDF-2012/31-2012.pdf)
10. Njohuri në Microsoft SQL server:  
<https://books.goalkicker.com/MicrosoftSQLServerBook/>
11. Njohuri mbi The Global Statistical Geospatial Framework për integrimin e të dhënave gjeohapësinore me të dhënat statistikore.  
[https://ggim.un.org/meetings/GGIM-committee/9th-Session/documents/The\\_GSGF.pdf](https://ggim.un.org/meetings/GGIM-committee/9th-Session/documents/The_GSGF.pdf)

### **1.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me dokumentacionin e dorëzuar:

Kandidatët do të vlerësohen për përvojën, trajnimet apo kualifikimet e lidhura me fushën, si dhe për vlerësimet e rezultateve individuale në punë. Totali i pikëve për këtë vlerësim është 40 pikë.

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

Totali i pikëve për këtë vlerësim është 60 pikë.

### **1.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse në Institutin e Statistikave do të shpallë fituesin në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut. Të gjithë kandidatët pjesëmarrës në këtë procedurë do të njoftohen individualisht në mënyrë elektronike, për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail).

---

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4) 2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) / [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

## **2. PRANIMI NË SHËRBIMIN CIVIL NË KATEGORINË EKZEKUTIVE**

Vetëm në rast se nga pozicionet e renditura në fillim të kësaj shpalljeje, në përfundim të procedurës së lëvizjes paralele, rezulton se ende ka pozicione vakante, këto pozicione janë të vlefshme për konkurimin nëpërmjet procedurës së pranimit në shërbimin civil për kategorinë ekzekutive. Këtë informacion do ta merrni në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe stendat e informimit të publikut duke filluar nga data 4 Nëntor 2024.

### **2.1 KUSHTET QË DUHET TË PLOTËSOJË KANDIDATI NË PROCEDURËN E PRANIMIT NE SHËRBIMIN CIVIL DHE KRITERET E VEÇANTA**

Për këtë procedurë kanë të drejtë të aplikojnë të gjithë kandidatët jashtë sistemit të shërbimit civil, që plotësojnë kërkesat e përgjithshme sipas nenit 21, të ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kushtet që duhet të plotësojë kandidati në procedurën e pranimit në shërbimin civil janë:

- a- Të jetë shtetas shqiptar;
- b- Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- c- Të zotërojë gjuhën shqipe, të shkruar dhe të folur;
- d- Të jetë në kushte shëndetësore që e lejojnë të kryejë detyrën përkatëse;
- e- Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e një krimi apo për kryerjen e një kundërvajtjeje penale me dashje;
- f- Ndaj tij të mos jetë marrë masa disiplinore e largimit nga shërbimi civil, që nuk është shuar sipas ligjit 152/2013 “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.

Kandidatët duhet të plotësojnë kriteret e veçanta si vijon:

- a- Të ketë arsim të lartë në Inxhinieri Informatike/Teknologji Informatike/Gjeologji/Informatikë/Gjeoinformatikë/Gjeografi, niveli “Master Profesional”. Edhe diploma Bachelor të jetë në të njëjtat fusha.

---

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) / [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

## **2.2 DOKUMENTACIONI, MËNYRA DHE AFATI I DORËZIMIT**

Kandidatët që aplikojnë duhet të dorëzojnë dokumentat si më poshtë:

- a- Kërkesa për pozicionin e kërkuar
- b- Jetëshkrim i aplikantit;
- c- Fotokopje të diplomës;
- d- Fotokopje të librezës së punës (të gjitha faqet që vërtetojnë eksperiencën në punë);
- e- Fotokopje të letërnjoftimit (ID);
- f- Vërtetim të gjendjes shëndetësore;
- g- Vetëdeklarim të gjendjes gjyqësore.
- h- Çdo dokumentacion tjetër që vërteton trajnimet, kualifikimet, arsimim shtesë, vlerësimet
- i- pozitive apo të tjera të përmendura në jetëshkrimin tuaj;

Dokumentat duhet të dorëzohen me postë apo drejtpërsëdrejti në Institutin e Statistikave brenda datës **17 Tetor 2024**.

## **2.3 REZULTATET PËR FAZËN E VERIFIKIMIT PARAPRAK**

Në datën 4 Nëntor 2024, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të shpallë në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive”, në faqen e internetit të Institutit të Statistikave dhe standat e informimit të publikut, listën e kandidatëve që plotësojnë kushtet dhe kriteret e veçanta për procedurën e pranimit në kategorinë ekzekutive si dhe datën, vendin dhe orën e saktë ku do të zhvillohet testimi me shkrim dhe intervista.

Në të njëjtën datë kandidatët që nuk i plotësojnë kushtet e pranimit në kategorinë ekzekutive dhe kërkesat e posaçme do të njoftohen individualisht (nëpërmjet adresës së e-mail), për shkaqet e moskualifikimit.

---

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 / 2222411 / 2233358 / 2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) / [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)



---

**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
INSTITUTI I STATISTIKAVE**

**2.4 FUSHAT E NJOHURIVE, AFTËSITË DHE CILËSITË MBI TË CILAT DO TË ZHVILLOHET TESTIMI DHE INTERVISTA**

Kandidatët do të testohen me shkrim për njohuritë mbi dokumentet e listuara në pikën 1.4

Kandidatët gjatë intervistës së strukturuar me gojë do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Njohuritë, aftësitë, kompetencën në lidhje me përshkrimin e pozicionit të punës;
- b- Eksperiencën e tyre të mëparshme;
- c- Motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën.

**2.5 MËNYRA E VLERËSIMIT TË KANDIDATËVE**

Kandidatët do të vlerësohen në lidhje me:

- a- Vlerësimin me shkrim, deri në 60 pikë;
- b- Intervistën e strukturuar me gojë që konsiston në motivimin, aspiratat dhe pritshmëritë e tyre për karrierën, deri në 25 pikë;
- c- Jetëshkrimin, që konsiston në vlerësimin e arsimimit, të përvojës e të trajnimeve, të lidhura me fushën, deri në 15 pikë.

**2.6 DATA E DALJES SË REZULTATEVE TË KONKURIMIT DHE MËNYRA E KOMUNIKIMIT**

Në përfundim të vlerësimit të kandidatëve, Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të njoftojë ata individualisht në mënyrë elektronike për rezultatet (nëpërmjet adresës së e-mail). Drejtoria e Burimeve Njerëzore, Financës dhe Shërbimeve Mbështetëse, në Institutin e Statistikave do të shpallë fituesin në faqen zyrtare të internetit të INSTAT, në portalin “Agjencia Kombëtare e Punësimit dhe Aftësive” dhe stendat e informimit të publikut.

Të gjithë kandidatët që aplikojnë për procedurën e pranimit në shërbim civil në kategorinë ekzekutive, do të marrin informacion në faqen e internetit të Institutit të Statistikave, për fazat e mëtejshme të kësaj procedure duke filluar nga data 4 Nëntor 2024.

---

**INSTITUTI I STATISTIKAVE**

Rr. “Vllazën Huta” Nr. 35, H. 1, Njësia Administrative Nr. 2, 1017 Tiranë, SHQIPËRI,

Tel: +355 (4) 2233356 /2222411 / 2233358 /2233357 / Fax: + 355 (4)2 228300

[www.instat.gov.al](http://www.instat.gov.al) / [info@instat.gov.al](mailto:info@instat.gov.al)